




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr Prot Br Prot Prot No
Nr. ffaq Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
2D	01-168/15
02	22.01.2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.01.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3930-14 për z.Hasan Sadiku – Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-3930-14, për Zyrtarin e lartë, z. Hasan Sadiku – Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Hasan Sadiku fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtaret e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Sadiku, është deklaruar se tashmë i është aprovuar kërkesa e tij për shlyerje nga regjistri në Odën e Avokatëve të Kosovës (Dpk/Dpki-03-4563/14), dhe ndërkohë ka premtuar se do të bëjë edhe ç'regjistrimin e Avokatures se tij edhe në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, z.Sadiku, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK/DPKI-03-03-02/62/15) në të cilën shihet se është bërë shuarja vullnetare e biznesi privat,

“Avokat Hasan Sadiku”, duke parandaluar kështu konfliktin e interesit me funksionin e tij publik– Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

